



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 13.05.2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Mufera Shinik, Abdyl Salihu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Arbërie Nagavci, Driton Çausi, Luljeta Veselaj – Gutaj, Albulena Balaj-Halimaj dhe Fidan Rekaliu.

Munguan: Teuta Haxhiu dhe Verica Çeraniç.

Përfaqësues të tjerë: Isuf Koci dhe Hilmi Demolli, përfaqësues të KKTK dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.03.2019, 15.03.2019, 01.04.2019 dhe 03.04.2019;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2018;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.03.2019, 15.03.2019, 01.04.2019 dhe 03.04.2019

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 11.03.2019, 15.03.2019, 01.04.2019 dhe 03.03.2019 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2018

Ismail Kurteshi hapi mbledhjen dhe fjalën ia dha përfaqësuesve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për të prezantuar raportin e punës për vitin 2018.

Isuf Koci tha se në bazë të obligimeve ligjore kanë përgatitur raportin vjetor të punës se Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) të cilin e kanë përcjellë në Kuvend brenda afateve të përcaktuara. Raporti është një pasqyrë e aktiviteteve të cilat i kanë përmbushur ata si institucion brenda vitit 2018, edhe pse, tha ai, si institucion nuk janë të kënaqur për gjendjen në të cilën gjendet trashëgimia kulturore. Ai sqaroi se anëtarëve të KKTK, më datë 23.07.2018, u ka skaduar mandati dhe procesi i emërimit të anëtarëve pritet të bëhet nga Kuvendi. Ai përmendi sfidat e mos bashkëpunimit të duhur nga institucione të ndryshme. Ndër aktivitetet me të rëndësishme gjatë vitit 2018, përmendi hartimin e Raportit përmbledhës për gjendjen e trashëgimisë kulturore për periudhën 10 vjeçare, i cili i është prezantuar edhe Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve tjera. Raporti konstaton që për një periudhë 10- vjeçare janë shpenzuar rreth 20 milionë euro për trashëgimi kulturore, ku është investuar në 100 asete të trashëgimisë kulturore. Një aktivitet tjetër që është realizuar mbi 80% por për arsye objektive nuk ka arritur të jetë pjesë e raportit të vitit të kaluar, është raporti për zonat e veçanta të mbrojtura, ku gjithsej janë 43 zona të veçanta, ky raport pritet të përfundojë këtë vit. Më tej përmendi edhe procesin e zhvillimit të platformës elektronike në të cilën qasje do të kenë Ministria e Kulturës dhe qendrat rajonale të trashëgimisë kulturore, ku i gjithë procesi është transparent dhe të gjithë qytetarët mund të shohin se ku është procesi dhe për sa pritet të përfundojë. Një sfidë tjetër që e ka tejkaluar kjo platformë ka të bëjë me afatet, sepse përmes kësaj platforme nuk do të ketë mundësi të tejkalimit të afateve. Ku një aset nga faza e aplikimit e deri te faza e shpalljes përfshin një afat prej tre muajve, ku edhe do marrë përgjigje negative ose pozitive, varësisht nga vendimi që merr institucioni në bazë të dhënave që ata kanë. Një aktivitet të cilin ne e kemi radhitur si aktivitetin e tretë më të rëndësishëm është aplikimi për anëtarësim në Join Programm Initiative Of Cultural, është një nismë e cila është në kuadër të Këshillit të Evropës, ku janë 18 anëtarë të rregullt dhe 7 anëtarë vëzhgues. KKTK ka aplikuar vitin e kaluar dhe po presim që këtë vit të anëtarësohemi. Në anëtarësimin e kësaj nisme Këshilli i Kosovës do të ketë dy anëtarë në bordin drejtues, ku njeri mund të jetë përfaqësues nga Këshilli dhe një nga

Ministria e Kulturës ose cilitdo institucion tjetër të Republikës së Kosovës. Ai tha që vitin e kaluar ata kanë realizuar disa punëtori që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore dhe zonat e veçanta. Ligji për Trashëgimi Kulturorë përcakton se zona e veçantë rreth monumenteve të trashëgimisë arkitekturën është 50 metra, ndërsa rreth aseteve të trashëgimisë arkeologjike është 100 metra, jo çdo herë, ndoshta shumë herë këto zona nuk respektohen. Të gjitha këto aktivitete që i cekëm kanë të bëjnë me përgjegjësitë ligjore që i kemi. Në raportin që kemi paraqitë për vitin 2018 është identifikuar që një masë e madhe e buxhetit shkojnë për objektet nuk janë pjesë e trashëgimisë kulturore.

Ismail Kurteshi, në diskutimin e tij rreth raportit të punës së KKTK për vitin 2018 tha se është pozitive që raporti i vitit 2018 përshkruan me shumë aktivitete se sa ai një viti me parë, pra i vitit 2017, kjo tregon që ka pasur një punë me të madhe, por ka disa gjëra që KKTK i ka futur në raport si aktivitete të cilat nuk mendoj që e kanë vendin këtu. Përveç tjerash keni thënë që sfida mbetet moszbatimi i Ligjit për trashëgiminë kulturore dhe ligjeve e tjera në fushën e MKRS. Në raport është thënë që gjatë vitit 2018 nga institucionet varëse të Ministrisë së Kulturës nuk është dorëzuar asnjë aset i trashëgimisë kulturore për vlerësim dhe janë shpallë në mbrojtje të përhershme, dhe konstatimi se gjendja e rëndë e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës vjen si rezultat i planifikimit jo të mirë të prioriteteve financiare, realizimit ad-hoc të projekteve, mos vlerësimit të projekteve. Ai tha se edhe përkundër ndarjes së buxhetit për trashëgimi kulturore gjendja mbetet e njëjtë për shkak të mos menaxhimit të mirë dhe shpenzimit të buxhetit kryesisht për paga dhe mëditje, pra nga 218 mijë 287 euro e 97 cent aq sa KKTK e ka buxhetin, mbi 130 mijë euro janë shpenzuar për paga dhe mëditje. Më tej kërkoj sqarim lidhur me konferencën që ka organizuara KKTK, ku kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësuesit e trashëgimisë kulturore të shteteve fqinje siç është Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe nga aty kanë dalë disa përfundime dhe i keni shkëmbyer disa përvoja, andaj kërkoj sqarim lidhur me përfitimet nga konferenca e organizuar.

Arbëria Nagavci, në diskutimin e saj rreth raportit të punës së KKTK, kërkoj sqarim lidhur me atë se mungesa e bordit të KKTK sa ka ndikuar në realizimin e planifikimeve për vitin 2018. Çështja tjetër që u ngrit kishte të bënte me mos dorëzimin e dosjeve nga ana e MKRS për vlerësimin e aseteve në KKTK, gjë e cila është evidentuar edhe në raport dhe si dukuri ka ndodhur qysh nga themelimi i KKTK. Më tej kërkoj sqarim rreth funksionimit të platformës elektronike. Çështje tjetër që ngriti kishte të bënte me trafikim e objekteve të luajtshme për shkak të mungesës së personave të licencuar, duke iu kërkuar përfaqësuesve të shpjegohet kjo pjesë më qartë.

Luljeta Veselaj -Gutaj, tha se edhe në takimet e mëhershme janë diskutuar disa nga sfidat me të cilat përballët KKTK, e të cilat janë të evidentuara përsëri në raport. Tha se mos votimi i anëtarëve të KKTK nga ana e Kuvendit padyshim që ndikon në punën e këshillit. Më tej kërkoj sqarim lidhur me raportet e KKTK me Departamentin e Kulturës në MKRS.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, tha se e përkrah raportin e KKTK dhe tha se është neglizhencë e Kuvendit mos zgjedhjen e anëtarëve të KKTK, kur dihet se Komisioni ka bërë përzgjedhjen e tyre.

Isuf Koci tha se në kuadër të aktiviteteve janë përmend disa sfida, mirëpo në masën 70% është realizuar plani i punës së KKTK për vitin 2018, duke marrë parasysh që deri me datën 23.07.2019 KKTK ka qenë funksional.

Sa i përket pjesës së vlerësimit të projekteve, prej vitit 2010 ne i kemi përcjellë shkresa çdo ministri që ka qenë në detyrë, për vlerësimin e projekteve. Shkresa të cilat i kemi të gjitha, por për të cilat ne nuk kemi marr përgjigje asnjëherë. Sa i përket platformës ne e kemi filluar vitin e kaluar, ndërsa këtë vit në muajin Shkurt, ka përfunduar trajnimi i të gjithë zyrtarëve tonë kompetentë rreth platformës. Sa i përket pengesave në bashkëpunim, ne sigurisht kemi pasur sepse, nuk kemi mundur t'i nxjerrim raportimet me të mira. Ndërsa sa për relaksimin e raporteve, ai tha se, nuk kemi problem me askënd, por kur ne po raportojmë drejt dhe për gjendjen reale dikujt s'po i pëlqen dhe po fillojnë këto problemet. Por ne do të vazhdojmë të raportojmë ashtu si duhet rreth gjendjes reale në trashëgiminë kulturore, sepse gjendja e trashëgimisë është më e rëndësishme se sa raportet tona. Sa i përket pyetjes se fundit të kryetarit, ky aktivitet ka pasur të bëjë me trajtimin e një teme që është paraqitur edhe në raportin për gjendje. Është problematikë shumë e madhe, problematikë për pronaret, për shoqërinë, por edhe për neve si institucion, e kjo ka të bëjë me statutin e aseteve në mbrojtje të përkohshme. Sepse ne kemi asete në mbrojtje të përkohshme nga viti 2011, të paktën ligjërisht me lista, të cilën ministrat e Ministrisë së Kulturës vetëm e përtërijnë dhe vazhdojnë mandatin. Kurse ligji për trashëgimi kulturore, konkretisht neni 3.6 i këtij ligji përcakton se; asetet e trashëgimisë kulturore duhet të jenë në mbrojtje vetëm një vit. Dhe për ta trajtuar këtë temë, ne e kemi mbajtur një punëtori ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe mbi bazën e kësaj punëtorie janë nxjerrë disa konkluzione. Një nga konkluzionet që është nxjerrë ka të bëjë me afatet, pra afatet duhet të respektohen. Dhe afati në Kosovë për asetet në mbrojtje të përkohshme është një vit, dhe pas një viti ministria duhet ta propozojë atë aset për mbrojtje të përhershme, nëse nuk ndodh diçka e tillë atëherë ligjërisht ai aset nuk është më në mbrojtje. Sa i përket konkluzioneve tjera do e bëjmë një përmbledhje të tyre dhe do t'ua dorëzojmë juve, por sigurisht që të gjitha janë në frymën ligjore brenda përgjegjësisë ligjore. Lidhur me çështjen e ngritur për trafikimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, tha se në bazë të ligjit për trashëgimi kulturore Ministria e Kulturës ka nxjerrë një rregullore e cila ka të bëjë me licencimin e personave për blerjen dhe shitjen e aseteve, por ministria nuk e ka licencua asnjë person, ne kemi identifikuar që në disa faqe ka trafikim të hapur të aseteve të trashëgimisë kulturore.

Ismajl Kurteshi kërkoj sqarim lidhur me atë se, Ministria e Kulturës ka pasur përfaqësues aty në punëtori a janë pajtuar me këto konkluzione, sidomos me afatet.

Isuf Koci tha se s'kemi marrë fare përgjigje nga përfaqësuesit e institucioneve.

Ismail Kurteshi, pasi u dëgjua raporti nga përfaqësuesit e KKTK dhe përgjigjet që ata dhanë ndaj deputetëve kërkoj nga deputet që të japin votën e tyre pro ose kundër këtij raporti duke e hedhur në votim.

Anëtarët e komisionit unanimisht miratuan raportin e punës së KKTK për vitin 2018, dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim.

4. Të ndryshme

Ismail Kurteshi ngriti çështjen e nismës për plotësim-ndryshimin Ligjit për Paga që ka të bëjë me nivelimin e pagave të mësimitdhënësve nga klasa e 1 deri në klasën e 5 me mësimitdhënësit nga klasa e 6 deri në klasën e 9. Tha se komisioni ka marrë një peticion dhe që kanë diskutuar me një delegacion të këtyre mësuesve dhe pas këtij diskutimi ne, si komision, jemi pajtuar që të marrim nismën që të fillojmë plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Dhe për ta bërë këtë duhet nënshkrimet tona si komision, pastaj ne duhet të bëjmë një kërkesë në Kryesinë e Kuvendit që ta ngarkojë Qeverinë për fillimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Paga.

Luljeta Veselaj – Gutaj, tha se ka qenë dhe është shqetësim i përbashkët i të gjithëve dhe jemi pajtuar edhe me herët që iu është bërë një diskriminim këtyre mësimitdhënësve. Ajo pyeti se a ka pasur me herët ndonjë rast në Kuvendin e Kosovës që ka proceduar në këtë formë, çështja është që ta dimë se a do këtë rezultat. Tha se duhet gjetur një formë me të shpejtë për ndryshimin e Ligjit për Paga, nga se mendon se kjo formë merr kohë.

Arberie Nagavci, tha se do ta mbështesë këtë nismë sepse ky grup i mësuesve është diskriminuar. Dhe është mirë që kërkesën që ia dorëzojmë Kryesisë, ta cekim që kjo kërkesë të merret si prioritet në mënyrë që të rregullohet kjo çështje para se ligji të hyjë në fuqi.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, mbështet kërkesën, sepse këta mësimitdhënës po kërkojnë vetëm atë që iu takon. Ajo tha se, si LDK e përkrahin këtë plotësim ndryshim të ligjit të pagave, sepse është me vend.

Albulena Balaj –Halimaj tha se për të qenë të qartë edhe NISMA e mbështet këtë kërkesë për rritjen e koeficientit dhe kështu ka qenë prej fillimi. E jona është ta marrim këtë nismë, e të mos supozojmë se çfarë bënë qeveria, ne të marrim nismë e pastaj ia lëmë kryesisë edhe qeverisë.

Luljeta Veselaj- Gutaj tha që sikur mësimitdhënësve edhe pedagogëve edhe psikologëve iu ka bërë diskriminim. Sepse një pedagog ose psikolog merret me mbi 100 nxënës edhe e ka koeficientin 1.9, e kjo është shumë diskriminuese në raport me psikologët klinik të cilët e kanë 3.2 koeficientin. Dhe psikologët klinik punojnë në klinika dhe kanë disa raste të caktuara, ndërsa psikologët tjerë punojnë në shkolla dhe mbikëqyrin minimum 1000 nxënës. Ndoshta ka mundësi që kërkesës me ia bashkëngjitur edhe koeficientit e psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkolla. Është një grup që është diskriminues njëjtë si mësimitdhënësit, nuk është numri i madh i tyre, por mendoj që është mirë të bëhet edhe kjo sepse edhe këtyre i është bërë një diskriminim.

Arberie Nagavci tha se pajtohet me propozimin e Luljetës, dhe se është e drejtë të kenë koeficientin e njëjtë me mësimitdhënësit e shkollës së mesme.

Albulena Balaj –Halimaj tha se e mbështet këtë propozim edhe pse nëse hyjmë te psikologët dhe pedagogët mund të kemi telashe me ligjin.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, tha që këtij teksti që kemi me ia shtuar edhe këtë propozim dhe se besoj që ia vlen të diskutohet më shumë.

Ismajl Kurteshi tha se pajtohet me propozimin e Luljetës, që të plotësohet kërkesa duke përfshirë edhe pedagogët e psikologët dhe ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen me votë rreth kërkesës:

Pas diskutimeve anëtarët e komisioni unanimisht vendosën që Kryesisë së Kuvendit t'i paraqesin këtë kërkesë:

- Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të hartojë projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-111 për pagat në sektorin publik.

Kërkesa e Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Paga ka për qëllim të barasvlerësimit të koeficienteve të mësimdhënësve 1-5 me mësimdhënësit 6-9, si dhe ngritjen e koeficientit të pedagogëve dhe psikologëve që janë të punësuar në shkolla.

Ismajl Kurteshi i njoftoi anëtarët e komisionit se vizita në Luginën e Preshevës do të realizohet më 5-6 qershor 2019.

Çështje tjetër përmendi edhe vizitat e komisionit në Institutin Pedagogjik, Albanologjik dhe të Historisë, ku jemi njoftuar me punën e tyre, por edhe me problemet që i kanë. Propozoj që të caktohet një takim me ministrin e MASHT për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e instituteve me theks të veçantë ato të Institutit të historisë.

Ismajl Kurteshi tha se ka pranuar një shkresë nga KDI, përmes së cilës ata kanë shpreh interesim të marrin pjesë në një takim që do e kemi me ministrin e Arsimit lidhur me nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit, si dhe një shkresë nga profesori, Avni Preshava, propozimi i tij është që t'i ndryshohet emri i Fakultetit të Edukimit në Fakultet të Mësuesisë, dhe kërkesë e tij është që atij t'i mundësohet që të vijë një ditë para komisionit dhe ta sqarojë idenë e tij.

Luljeta Veselaj –Gutaj tha se ne nuk jemi kompetentë për këtë çështje, dhe Fakulteti i Edukimit ka qenë Fakultet i Mësuesisë, por është kthyer në Fakultet të Edukimit për shumë arsye, për këtë arsye edhe nuk jam që ta dëgjoj.

Arberie Nagavci ngriti çështjen e Garave Nacionale, tha se është shqetësuese ajo që ka ndodhur në testimin e nxënësve, sepse kanë dalë shumë gabime në formulimin e pyetje, por edhe në përmbajtje të tyre. Sa kam informata, është krijuar një situatë ku ka pasur mospajtime, ku disa shkolla e prindër nuk kanë pranuar që fëmijët e tyre të mos jenë pjesë e këtij testi, në të njëjtën

kohë ka pasur shkolla që kanë qenë pjesë e këtij testi, organizmi, pra ka qenë shumë i keq. Por me problematikë ka qenë përmbajtja e tij, duke filluar nga aspekti pedagogjik e psikologjik. Në shumë vende, nxënësit e moshës së vogël nuk vlerësohen as me nota, e t'i vesh në testim nxënësit e klasës së 1 është shumë gabim. Tjetra, testet që janë ndarë në gjuhë shqipe në matematik dhe lëndët e tjera, kanë pasur shumë lëshime teknike, por edhe gabime përmbajtjesore, e atëherë si është e mundur që nxënësit t'i përgjigjen këtyre pyetjeve. Unë mendoj që ne duhet të thërrasim për raportim Ministrin e Arsimit rreth kësaj çështje, dhe t'i mësojmë arsyet pse nuk ka pasur bashkëpunim me koordinаторin për arsim. Përveç kësaj ka pasur diskutim edhe sa i përket kostos, ku janë ndarë 200 mijë euro, e ne duhet të dimë sa mjete ndahen dhe për çfarë ndahen ato.

Ismajl Kurteshi, propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet z. Rexhep Hoti, koordinatori Nacional për Rini për të raportuar lidhur me organizimin Garave Nacionale, si dhe të ftohet Ministri i Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi, për të diskutuar lidhur me sigurinë në shkolla.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi